



Planuar / Datede Planned / Datede Received / Delivery	28.04.2021	1	viti god year
Organ / Riposta Organ / Jedinka Org / list	No. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shërbimi Prilozh Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHOCK	2054/2021		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.230/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehemti dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit Anr.2259/2019 të datës 29.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë /Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.414/2019 të datës 18.07.201, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi Rr. "Gazmend Baliu", PN, Mitrovicë, kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe neni 18 paragrafin 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 28.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.414/2019 e datës 18.07.2019 e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 01-111/01-0050552-2/19, i datës 10.07.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

A r s y e t i m

Komuna e Mitrovicës së Jugut, bazuar në aprovimin e datës 01.04.2019 të Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike, ka shpallur me datë 04.04.2019 konkursin me Nr.07-111/01-0028057/2019 për pozitën "Zëvendës drejtor" i SHFMU "Migjeni", e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja, e cila është përfshirë në listën e ngushtë dhe ka marrë pjesë në të gjitha fazat e procedurës rekrutuese.

Me datë 31.05.2019 Komuna e Mitrovicës së Jugut ka publikuar Njoftimin nr.07-111/01-0028057-4/2019, për kandidatin e suksesshëm Sinan Shosholli për pozitën "Zëvendës drejtor" i SHFMU "Migjeni" në Mitrovicë të Jugut.

Ankuesja e pakënaqur me njoftimin e datës 31.05.2019 ka parashtruar ankesë me datë 13.06.2019 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Mitrovicës, ku ky i

fundit me Vendimin me numër protokolli 01-111/01-0050552-2/19 të datës 10.07.2019, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses. Kundër këtij Vendimi të KZAK-së, ankuesja brenda afatit ligjor respektivisht me datë 18.07.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.07.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën të Komuna e Mitrovicës. Më datë 14.08.2019, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020, ka qenë jo funksional për shkak të mos emërimit të anëtarëve nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me ç'rast Këshilli me shkresën me numër protokolli 3857/2019 të datës 26.08.2019, ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës së tij me numër A.nr.414/2019 të datës 18.07.2019, duke udhëzuar palën mbi të drejtën e ndjekjes së procedurës gjyqësore, në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ. Pas këtij njoftimi të Këshillit, ankuesi ka hapur konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, e cila me Aktgjykimin A.nr.2259/19 të datës 29.03.2021 i pranuar në Këshill me datë 01.04.2021, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, ka anuluar Njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 26.08.2019 dhe ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të vendos për ankesën e ankuesit të datës 18.07.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Aktgjykimin Anr.2259/2019 të datës 29.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë /Departamenti për Çështje Administrative; Ankesën me numër protokolli 880/2019 e datës 18.07.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 10.07.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të datës 28.01.2019; Njoftimi i datës 31.05.2019; Përgjigje në ankesë e datës 14.08.2019; Formulari A; Formulari B; Formulari E; Formulari H; Autorizimi nga DASHC/MAP i datës 01.04.2019; Ankesë e datës 13.06.2019 e komisionit për Ankesa; Flete dorëzim i datës 12.07.2019; Konkursi i datës 04.04.2019; Protokolli i intervistës i datës 24.05.2019; Formulari C; Formulari D; **Aplikacioni i pranuar i datës 15.04.2019,** Vërtetim i datës 12.04.2019, Referencë e datës 07.04.2019, Diplomë Universitare e datës 21.07.2000, Diplomë e datës 14.07.2016, Certifikata MASHT/GIZ, Certifikata e datës 27.04.2017, Certifikata e viti 2019, Certifikata e datës 03.06.2011, Certifikata e datës 27.09.2010, Certifikata e datës 03.11.2009, Certifikata e prillit 2014, Certifikata e tetorit 2004, Licencë e datës 03.12.2017, Certifikata e datës 30.09.2006, Certifikata e datës 30.06.2006, Certifikata e datës 30.09.2007, Certifikata e datës 26.09.2018, plani i zhvillimit shkollor i datës 20.01.2019; **Aplikacioni i pranuar i datës 17.04.2019,** Certifikata tetor 2018, Diplomë datës 05.04.2018, Diplomë universitare e datës 22.06.2015, Vërtetim i datës 07.04.2019, Vërtetim i datës 17.04.2019, Licencë e datës 03.12.2017, Vërtetim i datës 21.03.2012 për trajnim, Vërtetim i datës 25.03.2012 për trajnim, certifikatë dhjetor 2013, Certifikata dhjetor 2013, Certifikata e datës 11.07.2011, certifikatë e datës 24.09.2003, certifikatë 2017, Vërtetim i datës 19.03.2016, Certifikatë e datës 23.10.2016, certifikatë e datës 26.08.2007, certifikatë e datës 21.10.2007, Mirënjohje e datës 17.06.2011, CV, Punim seminari 2016 dhe 2016, Plani i zhvillimit 2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e pabazuar, sepse:**



Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se procedura e rekrutimit për pozitën Zëvendësdyrëtor i SHFMU "Migjeni", është zhvilluar në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ Nr.08/2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Dyrëtorit dhe të Zëvendësdyrëtorit të Institucionit Edukativo Arsimor dhe Aftësues, duke shtuar se Komisioni Përzgjedhës nuk ka bërë vlerësimin e drejtë të ankueses në raport me kandidatin e përzgjedhur i cili sipas deklarimeve të ankueses nuk ka fare përvojë në udhëheqje në arsim dhe ka vetëm 64 orë trajnim për udhëheqje në arsim.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se në konkursin e shpallur të datës 04.04.2019, për pozitën "Zëvendësdyrëtor" i SHFMU "Migjeni", në Mitrovicë të Jugut, kriteret e konkursit kanë qenë:

1. Të jetë shtetas i Republikën e Kosovës,
2. Të ketë të kryesor së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240ECTS/4 vite të shkollimit universitar),
3. Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit ose të jetë në procedurë të licencimit,
4. Të ketë së paku 3 vite përvojë pune në arsim ose në institucione të arsimit,
5. Të ketë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim dhe menaxhim.

Kolegji bazuar në shkresat e lëndës gjen se proceduara rekrutuese lidhur me pozitën për pozitën Zëvendësdyrëtor SHFMU "Migjeni" është zhvilluar në pajtim me Udhëzimin Administrativ të MASHT Nr.08/2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Dyrëtorit dhe të Zëvendësdyrëtorit të Institucionit Edukativo Arsimor dhe Aftësues, Ligjin nr.03/1-149 për Shërbimin Civilë dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civilë.

Lidhur me plotësimin e kriterëve sipas konkursit, Kolegji nga shqyrtimi i provave të lëndës ka vlerësuar se kandidati i rekomanduar sipas dëshmimeve në dosjen e aplikimit ka plotësuar kushtet e përcaktuara me konkurs respektivisht kandidati i zgjedhur posedon: **Edukimi:** Diplomë Universitare të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" NR. 711 të datës 06.06.2016 me të cilën dëshmohet se ka fituar titullin Bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, gjithsej 240 pikë-ECTS, Diplomë Universitare të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" NR. 266 të datës 20.04.2018 me të cilën dëshmohet se ka fituar titullin Master i Mësimdhënies në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, **Licencimi:** Vendim nr.prot:206 të datës 17.04.2019 të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për ripërtërijë të Licencës të mësimdhënësit të karrierës e vlefshme nga data 17.04.2019 deri me 16.04.2024, **Përvojë Pune:** Vërtetimin e datës 07.04.2019 të Dyrëtorit të SHFMU "Elmaz Peci" Rahovë me të cilin konfirmohet se punon në këtë shkollë si mësimdhënës i lëndës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe prej datës 01.03.2003 e tutje pa ndërprerje, **kualifikimet trajnuese profesional për udhëheqje, administrim dhe menaxhim:** Certifikatë trajnimi nr. "Ndërtimi i kapacitete të dyrëtorëve të shkollave për përmirësimin e qeverisjes, menaxhimit dhe qeverisjes" të lëshuar nga MASHT, USAID dhe fhi360, Certifikatë trajnimi nr.15545 "Plani Zhvillimor i Shkollës 24 orë" nga data 10,11,21 mars 2012 të lëshuar nga MASHT, The World Bank dhe Qendra për Arsim e Kosovës, Certifikatë trajnimi nr.15628/002 "Planifikimi i Projekteve të Shkollave 16 orë" nga data 24-25 mars 2012 të lëshuar nga MASHT, The World Bank dhe Qendra për Arsim e Kosovës.



Lidhur me pretendimin ankimor, se kandidati i zgjedhur nuk ka fare përvojë në udhëheqje në arsim, Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke u bazuar në kriteret e konkursit ku thuhet se: 4. *Të këtë së paku 3 vite përvojë pune në arsim ose në institucione të arsimit*, ka konstatuar se sipas konkursit nuk është kërkuar përvojë në udhëheqje, por përvojë pune në arsim se paku tri vite, e ndërlidhur me këtë kërkesë kandidati i zgjedhur sipas Vërtetimit të datës 07.04.2019 të Drejtorit të SHFMU "Elmaz Peci" në Rahovë, ka përvojë punë në arsim mbi 15 vjet, e mbi këtë bazë rrjedhë se pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Po ashtu, përkitazi me pretendimin ankimor se kandidati i zgjedhur ka vetëm 64 orë trajnim për udhëheqje në arsim, Kolegji duke ju referuar kriterëve të konkursit respektivisht kriterit 6 ku thuhet se: *Të këtë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim dhe menaxhim*, ka konstatuar se sipas konkursit është kërkuar ndjekja dhe përfundimi i trajnimeve profesionale të akredituara lidhur me udhëheqjen dhe menaxhimin, e jo numër i caktuar i orëve të trajnimit. Ndërlidhur me këtë kriter Kolegji bazuar në dokumentacionin e aplikimit ka gjetur se kandidati i zgjedhur ka përfunduar disa programe trajnime të akredituara nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë lidhur me menaxhimin dhe udhëheqjen e shkollave, në këtë kuptim rrjedhë se pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se edhe ankuesja në cilësi të kandidatit ka plotësuar kushtet e konkursit, mirëpo në bazë të Formularit "E", Komisioni Përzgjedhës ankuesen e ka vlerësuar me 76.33 pikë të përgjithshme, ndërsa kandidatin e ka vlerësuar me 92.66 pikë të përgjithshme, respektivisht si kandidatin me të suksesshëm për pozitën "Zëvendësdrejtor" i SHFMU "Migjeni", në këtë kuptim të nenit 40 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civilë ku përcaktohet se: *"Në Shërbimin Civilë emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin me të madhe total të pikëve në testimin me shkrim dhe gojë"*.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke ju referuar rrethanave dhe fakteve si me lartë ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Mitrovicës së Jugut, me Vendimin me numër protokollit 01-111/01-0050552-2/19 të datës 10.07.2019, ka shqyrtuar drejtë ankesën e ankuesit dhe ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Udhëzimin Administrativ MASHT Nr. 08/2014 Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendësdrejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike lidhur me çështjen e kontestuar.

Andaj, Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se procedura e rekrutimit për pozitën "Zëvendësdrejtor" i SHFMU "Migjeni" në Mitrovicë të Jugut, është zhvilluar në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës "*.

Kështu që, Kolegji për shqyrtimin e ankesës pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.230/2021.

Zyle Millaku GOJNOVCI

per. [Signature]
Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.